



**Universiteti  
European i  
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

# GUIDA E STUDIMEVE

## DP/BA/MA/DR 2020-2021

DIPLOMË PROFESIONALE / BACHELOR / MASTER PROFESIONAL / MASTER I SHKENCAVE / MASTER EKZEKUTIV / PROGRAME TË INTEGRUARA / DOKTORATURË

kontabilitet menaxhim turizëm financë menaxhim biznesi drejtësi marrëdhënie ndërkombëtare shkenca politike sociologji dizajn i aplikuar dhe modë psikologji komunikim arte pamore filozofi histori letërsi linguistikë arte skenike arte muzikore arsim parashkollor edukim fizik dhe sporte aplikime informatike teknologji informacioni inxhinieri informatike inxhinieri industriale inxhinieri ndërtimi infermieri fizioterapi imazheri

**FAKULTETI  
I EKONOMISË  
BIZNESIT  
DHE ZHVILLIMIT**

**FAKULTETI I SHKENCAVE  
JURIDIKE, POLITIKE  
DHE MARRËDHËNIEVE  
NDËRKOMBËTARE**

**FAKULTETI  
I SHKENCAVE HUMANE,  
EDUKIMIT DHE  
ARTEVE LIBERALE**

**FAKULTETI  
I INXHINIERISË,  
INFORMATIKËS  
DHE ARKITEKTURËS**

**FAKULTETI  
I SHKENCAVE  
MJEKËSORE  
TEKNIKE**





# HISTORIKU & DEKADA E PARË

Që prej themelimit të tij, UET ka treguar se është universiteti i të gjithëve, i studentëve, pedagogëve, aktorëve shoqërorë dhe politikisht neutral, duke qenë universalisht i hapur ndaj të gjithëve, rrymave, ideve, krahëve politikë, tendencave apo grupeve shoqërore.

**Misioni i UET:** Integrimi në shoqëri nëpërmjet dialogut, ideve, projekteve, debateve, duke kontribuar si motori i ekonomisë, me ndërtimin e rrjeteve ndërkombëtare, por edhe duke patur përgjegjësinë për tu angazhuar me qëllimin e vetëm për të shtuar vlerat e shoqërisë shqiptare.

**Vizioni i UET:** Qasja jonë dalluese ndaj kërkimit, edukimit dhe inovacionit do të frymëzojë më tej komunitetin, pedagogët, studentët dhe partnerët, duke i udhëhequr drejt një shoqërie të dijes sa më funksionale në dobi të shoqërisë

## 15 VITE/ DREJTUESIT



23 SHTATOR  
2006

**THEMELUESIT DHE DREJTUESIT E PARË**  
Adri Nurellari, Tonin Gjuraj, Henri Çili, Ferit Duka, Romeo Gurakuqi,  
Ermal Hasimja, Blendi Kajsia



31 MARS  
2018

**EKIPI I PARË I RISTRUKTURIMIT DHE I ZGJERIMIT TË UET**  
Arben Dushi, Dritan Egro, Arbi Agalliu, Tonin Gjuraj, Drita Kruja, Agim Kukeli,  
Ferit Duka, Nevila Nika, Adrian Civici, Isuf Kalo, Selami Xhepa



**HENRI ÇILI**  
Administrator EEL shpk, 2006-2017



**ARBI AGALLIU**  
Administrator EEL shpk, 2018-2019



**TEUTA DOBI**  
Presidente, 2010-2011



**ADRIAN CIVICI**  
President, 2011-2019



**FERIT DUKA**  
Rektor, 2006-2007



**ADRIAN CIVICI**  
Rektor, 2007-2010

### Administratorët, Presidentët dhe Rektorët e UET

Në afro 15 vite të jetës së shoqërisë tregtare e EEL shpk dhe të UET është krijuar një traditë e re në menaxhim. Personalitete nga bota e menaxhimit dhe ajo akademike kanë dhënë kontributin duke krijuar një shkollë menaxhimi për arsimin e lartë privat.



**TONIN GJURAJ**  
Rektor, 2010-2018



# HISTORIKU & DEKADA E DYTË

## 10 DATA

**20 SHTATOR 2006**

Themelimi i Universitetit Europian të Tiranës

**23 KORRIK 2009**

Diplomimet e para në programet Bachelor

**24 KORRIK 2009**

Akreditimi i UET si Institucion dhe i programeve Bachelor

**20 KORRIK 2010**

Diplomimet e para në programet Master

**14 SHKURT 2011**

Akreditimi i programeve të ciklit të dytë dhe tretë (Master)

**28 SHTATOR 2011**

Marrja e statusit Universitet nga Shkollë e Lartë Universitare

**7 TETOR 2011**

Licencimi i programeve të doktraturës

**5 SHKURT 2015**

Akreditimi i programeve të doktraturës

**7 PRILL 2017**

5 vjet i akredituar me Vendim të Bordit të Administrimit nr. 12

**4 SHTATOR 2018**

Riorganizmi dhe licencimi i 5 fakulteteve

## 10 SHIFRA

**500**

libra të botuar nga UET Press

**500**

studentë të UET kanë kryer një cikël studimi jashtë Shqipërisë

**750**

Doktorë Shkencash

**1000**

bursa të plota/pjesëshme të akorduara nga UET ndër vite

**+ 1000**

pedagogë kanë qenë pjesë e UET në 14 vite

**+5000**

Studentë Bachelor

**5500**

Studentë Master

**+20000**

studentë të regjistruar në 14 vite akademike

**750 000**

euro, buxheti i kërkimit shkencor në vit, grante/botime

**5 000 000 000**

euro, kontributi i UET për përgjegjësinë sociale

Në dekadën e tij të dytë, UET vjen, jo vetëm si një institucion i afirmuar i arsimit të lartë, por edhe si një simbol i mirëfilltë i asaj çfarë një universitet duhet të jetë në një shoqëri të lirë demokratike; një hapësirë mundësish dhe mendimi, në të cilën gjithëkush mund të gjejë veten. Pas 14 vitesh kontribut në historinë e arsimit të lartë shqiptar, UET vjen i reformuar, me një ristrukturim dhe zgjerim të ofertës së tij akademike. Arsyeja e këtyre ndryshimeve është pikërisht dëshira për të qenë gjithnjë në rrokje të zhvillimit dhe cilësisë. Rikonceptimi i programeve aktuale të studimit, si dhe shtimi i dy fakulteteve të reja është hapi i radhës që ky universitet ndërmerr për të sjellë pranë studentit të tij më tepër cilësi. Tashmë fakultetet e UET janë 5, ku tri fakulteteve të mëparshme u janë shtuar dhe dy të tjera, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës.



**31 MARS  
2018**

**REKTORATI I NGUSHTË NË DEKADËN E DYTË**

Elvin Meka, Belina Budini, Arben Dushi, Endira Bushati, Pirro Prifti, Ermira Qosja, Selami Xhepa, Nevila Nika, Drita Kruja



**5 SHTATOR  
2018**

**REKTORATI I ZGJERUAR NË DEKADËN E DYTË**

Elvin Meka, Belina Budini, Arben Dushi, Endirë Bushati, Pirro Prifti, Ermira Qosja, Selami Xhepa, Nevila Nika, Drita Kruja, Roland Lami, Arlinda Ymeraj, Teuta Xhindi, Voltisa Lama, Marsida Duli, Edi Puka, Otjela Lubonja, Genciana Abazi Egro, Orkida Ilollari





UET

# BORDI I BESIMIT


**SELAMI XHEPA**

Figurë e njohur dhe profesor i shkencës së ekonomisë. Vjen në këtë pozicion të ri për të vijuar një traditë të shkëlqyer në funksionimin që i jep roli i Presidentit, si pjesë e imazhit dhe e komunikimit publik të universitetit


**ARJANA FULLANI**

Juriste e njohur dhe me emër në botën profesionale të jurisprudencës shqiptare. Fullani ka qenë anëtare e Gjykatës së Lartë dhe është njëkohësisht një njohëse dhe aktiviste e fortë e shoqërisë civile


**MUSTAFA NANO**

Publicist dhe gazetar i njohur, ka qenë i afërt me universitetin prej vitesh, duke botuar disa libra dhe duke u bërë pjesë e projekteve të ndryshme. Zë publik, i cili mbështet në mënyrë aktive humanitetet si një mënyrë për ndërtimin e shoqërisë


**ARBEN BIÇOKU**

Një nga zërat publikë të çështjeve të arkitekturës në jetën publike shqiptare. Ai është një ndër profesionistët më në zë të fushës, dhe ka qenë kontribuues në shumë evente, aktivitete dhe projekte të UET.


**ISUF KALO**

Dekani themelues i Fakultetit të Shkencave Teknikë Mjekësore në UET, ka kontribuar në ngritjen e këtij fakulteti me një punë të filluar rreth dy vite më parë, duke vënë gurin e themelut në një fakultet ambicioz nesër të Shkencave Mjekësore.



UET

# BORDI I ADMINISTRIMIT



KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT  
HENRI ÇILI

Të aksesueshëm  
dhe të dobishëm  
për të gjithë

**M**bi këtë filozofi kemi filluar tashmë rrugëtimin me riformatimin e Universitetit Europian të Tiranës në të gjithë planet. Zgjerimi i programeve të studimit dhe në përgjithësi i ofertës akademike, ristrukturimi i të gjitha programeve ekzistuese, riorganizimi, përsosja e praktikave menaxheriale kanë krijuar një UET të ri. Duke filluar nga viti akademik 2019-2020, Universiteti Europian të Tiranës falë disa reformave të guximshme dhe të suksesshme, vjen i konsoliduar në disa prej aspekteve të tij kryesore.

**Së pari:** Në UET mund t'i gjeni tashmë të gjitha ciklet e studimit, të gjitha llojet e diplomave dhe pothuajse të gjitha fushat e studimit, nga ekonomia tek financa, nga shkencat juridike, tek ato politike apo marrëdhëniet ndërkombëtare, nga shkencat sociale të aplikuara tek komunikimi, nga humanitetet dhe degët sokratike tek artet, nga edukimi tek sportet, nga teknologjitë e informacionit tek shkencat kompjuterike, nga inxhinieritë industriale tek arkitektura dhe urbanistika, për të përbyllur me hapjen e guximshme drejt shkencave mjekësore teknike, infermieri, fizioterapi, imazheri. Inkuadrimi i gjithë kësaj oferte akademike, nën një logo me pothuajse 15 vjet përvojë, e bën këtë hap të zgjerimit të Universitetit Europian të Tiranës të guximshëm, mëse realist. Gjithashtu përmbyllja e të gjithë cikleve të studimit nga Diplomat Profesionale, për studentët me mesatare nën 6 apo 7, dhe të gjitha ciklet e tjera të studimit deri në Doktoraturë, llojet e programeve të studimit, ciklet e studimit, e bën po ashtu UET të pasur edhe nga pikëpamja e gjeneratave, interesave për formimin akademik.

**Së dyti:** Po bëhen gati 15 vite nga ideja e krijimit dhe themelimit zyrtar të UET dhe pas tij ka tashmë një histori: mijëra dhe mijëra studentë që kanë kaluar në auditorët e UET, më shumë se 10,000 diploma, më shumë se 3 procese akreditimi nga të cilat 2 ndërkombëtare, praktika dhe procese akademike të konsoliduara. Kudo gjen një shenjë të UET! Diploma të të gjitha cikleve, shtresa të ndryshme shoqërore dhe një formë shumë e konsoliduar gati 15 vjeçare e traditës së re të universiteteve private në Shqipëri.

**Së treti:** Të marrësh diplomën në një universitet prestigjioz do të thotë të jesh pjesë e një rrjeti të madh dhe me ndikim në shumë sektor të shoqërisë.. Më shumë se 10,000 studentë të UET janë diplomuar, më shumë se 20,000 kanë shkëlur në dyert e tij, më shumë se 1,000 pedagogë kanë qenë pjesë e eksperiencës sonë akademike në këto vite, dhe kjo shtuar edhe specifike që ka një universitet privat, e bën idenë e përkatësisë në një rrjet shumë të fuqishme. Kudo do gjesht një ish-student apo pedagog të UET. Kudo në biznes, në institucione, në organizata ndërkombëtare, në shoqëri civile apo administratën publike, do të gjesht një ish-student të UET i cili do të mbështesë nëse ti zgjedh të studiosh në UET.

**Së katërti:** UET ka hedhur bazat për të qenë ndërkombëtar. Një numër jashtëzakonisht i madh studentësh dhe pedagogësh janë pjesë e programeve të Bashkimit Europian, janë pjesë e programeve Erasmus+, programeve të tjera të panumërta të BE dhe të shkëmbimeve me universitete të tjera perëndimore, duke bërë të mundur që thuajse çdo ditë të kemi një profesor të huaj që vjen, studentë të huaj që vijnë apo studentë të UET që nisen për një vizitë studimore apo për një semestër jashtë. Ky ndërkombëtarizim e sjell menjëherë standardin ndërkombëtar në UET, në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit dhe anasjelltas, i bën studentët dhe pedagogët tanë të maten në ekipet më të mira të universiteteve më të mira të Europës.

**Së pesti:** Aplikimi i teknikave më të mira të dekadës së parë, në fushat e reja bën që studentët shqiptarë të mund të marrin diploma në thuajse për të gjitha fushat e studimit, në një universitet të njohur dhe prestigjioz. Por jo vetëm kaq, një universitet i madh duhet të presë këdo. Duke filluar nga bursat e plota, gjysëm bursat, reduktimet apo financimi i studimeve, e bën UET një unviersitet për të gjithë, të cilin mund ta aksesojnë të gjitha shtresat dhe mund të marrin hapësirat dhe njohurinë në aulat e tij, të gjitha shtresat shoqërore pa dallime sociale apo të statusit ekonomik. Bursat "Kadare" për degët sokratike, gjysëm-bursat për një numër tjetër degësh dhe reduktimet mbi elementë që lidhen me ekselencën, rrjetin apo besnikërinë e personave që vijnë nga e njejta familje, janë tashmë praktika rutinë dhe të përdorshme për të gjithë në Universitetin Europian të Tiranës.

Kjo strategji e re, kjo faze e re e Universitetit Europian të Tiranës, në këtë dekadë të dytë e cila po jetësohet vit pas viti akademik, më bën krenar si një prej themeluesve të UET dhe si Kryetar i Bordit të Administrimit, të jem i sigurtë që ekipet tona, strukturat tona, Fakultetet tona, Departamentet tona të reja ose të riorganizuara do të presin çdo student, çdo prind, çdo aktor shoqëror në mënyrën e duhur për të krijuar një sinergji që vetëm univesiteti di ta bëjë në shoqërinë bashkëkohore ku jetojmë.



# PËRSHËNDETJA E PRESIDENTIT



PRESIDENTI I UET  
PROF. ASOC. DR. SELAMI XHEPA

Një universitet  
në shërbim  
të tregut  
dhe zhvillimit

Shoqëria e dijes e shekullit të ri, po transformon në mënyrë revolucionare jo vetëm kuptimin tonë rreth saj, por edhe vendin e institucioneve ku dija prodhohet dhe transferohet në shoqëri, siç janë institucionet e arsimit të lartë. Ky proces transformues i kapërcen dimensionet e ndryshimeve sistemike që përjetoi sistemi arsimor në Shqipëri, pasi ai nuk lidhet thjesht me adoptimin e një modeli të ri të edukimit dhe krijimit të aftësive profesionale të nevojshme për tregun e punës. Në ndryshim është i gjithë modeli i edukimit, një model që është bërje e sipër dhe që shpeshherë nuk arrin të rrokët njësoj nga vende apo institucione të caktuara të arsimit të lartë. Është një proces mbi të cilin po reflektojnë edhe universitetet që janë në kufijtë e prodhimit të dijes dhe me fat janë ata që e kuptojnë më shpejt dhe adoptohen ndaj ndryshimeve të tilla. Përgjithësisht sektori privat është gjithnjë më i mirëpozicionuar ndaj ndryshimeve të tilla. Ai ka të gjithë fleksibilitetin, motivin dhe mundësitë që të shndërrohet në pionier të eksperimentimit dhe adoptimit më përparuarës. Si gjithnjë, nevojat për mbijetesë janë një motiv i fuqishëm për inovacion dhe eksperimentim dhe kjo e bën një universitet privat zgjidhjen ndaj sfidave të arsimit të lartë, dhe jo problemin e tij. Dekada e dytë për Universitetin Europian të Tiranës ka nisur me sfida të reja. Një paketë programesh studimore e riformuar për ta lidhur ngushtësisht me profesionin e përzgjedhur prej studentëve, një zgjerim dijes në fusha të reja të shkencës dhe teknikës duke e bërë multidisiplinartetin një koncept funksional dhe jo teorik, dhe mbi të gjitha, një përditësim tërësor të të gjithë kurrikulës mësimore të të gjithë programeve me dijet më të fundit të fushave përkatëse, e kanë vendosur Universitetin Europian të Tiranës në një pozicion konkurrence sfidues në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Stafi i UET do të bëjë gjithçka për ta fituar këtë betejë të re, dhe në partneritet me shoqërinë dhe komunitetet, do të konsolidojë fort imazhin e vet si një universitet lider në Shqipëri.



UET para UET-it. Avokat Spartak Ngjela dhe liberalët e djathtë, 2005.



Ceremonia e diplomimit të parë, 2009





# PËRSHËNDETJA E REKTORES



REKTORJA E UET  
PROF. DR. NEVILA NIKA

Institucioni që  
kujdeset për çdo  
student, prind  
dhe familje

Të bëhesh Rektor i Universitetit European të Tiranës, i një universiteti në afro 15 vite të jetës akademike është një përgjegjësi e veçantë sepse universiteti është tashmë i konsoliduar, ai ka krijuar traditën e tij edhe pse jo shumë të gjatë po gati sa mosha e universiteteve private në Shqipëri. Kjo përgjegjësi më bën të them për studentët, prindërit dhe aktorët shoqërorë se ndjekja, bashkëpunimi apo çdo formë e pjesëmarrjes në një aktivitet, projekt apo iniciativë që UET ndërmerr në jetën shoqërore shqiptare është një sukses i garantuar. Ky sukses ka së paku tri pika mbështetje; Së pari, ka tashmë një traditë të praktikave të të gjitha llojeve që bëjnë që një universitet të jetë një organizëm i tillë me emrin e nderuar universitet Së dyti një staf akademik i qëndrueshëm, i vazhdueshëm, i madh dhe me një gamë të gjerë profilesh, dhe i aftë të japë kompetencën e tij në thuajse çdo fushë të zhvillimit të jetës, vendit apo të dijës universale Së treti do të thotë të mbështetesh kudo nga një rrjet i gjerë ish-studentësh ALUMNI të cilët tashmë e përforcojnë jehonën e UET, të studimeve apo të një diplome që kanë marrë në UET dhe të një eksperience sociale më shumë se 10,000 herë përta u përket studentëve të diplomuar dhe më shumë se 20,000 herë përta u përket studentëve të cilët në një mënyrë ose në një tjetër kanë qenë një herë pjesë e UET. E nejtja gjë mund të thuhet dhe me stafin akademik ku më shumë se 1,000 pedagogë të brendshëm ose të jashtëm me një dinamikë më shumë se 13 vjeçare kanë dhënë dijen dhe kompetencën e tyre në UET. Të tre këto faktorë më bëjnë të besoj se dekada e dytë e UET, të cilën unë kam nderin ta drejtoj akademikisht, na bëjnë t'i përgjigjemi kohës, t'i përgjigjemi momentit të ri dhe mbi të gjitha t'i përgjigjemi një brezi studentësh i cili kërkon një të ardhme tjetër, në një botë tjetër, për një Shqipëri tjetër.



Behgjet Pacolli, Honoris Causa i parë, 2011




Shkolla e parë sezonale, 2012

# MULTI / INTER DISIPLINARITET

1

Pas trembëdhjetë vitesh kontribut në historinë e arsimit të lartë shqiptar, UET vjen i reformuar, me një ristrukturim dhe "zgjerim" të ofertës së tij akademike. Tashmë fakultetet e UET janë 5, ku tri fakulteteve të mëparshme u janë shtuar dhe dy të tjera, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës. UET prej vitit 2018 ka në ofertën e tij akademike 75 programe dhe 125 profile, ç'ka e bën më të lehtë vendimmarrjen por dhe

përshtatjen e studentit pas diplomimit në tregun e punës, duke diplomuar jo vetëm një student të mirëinformuar dhe edukuar por edhe një specialist në profesion, i cili do të jetë një inxhinier i shoqërisë. Plotësimi i kuadrit thuajse të plotë të fushave dhe disiplinave të UET, është një mundësi për të gjithë për të bashkëvepruar me UET për një ide, projekt, shkollim për gjithçka që sinjifikon universitetin në një shoqëri demokratike dhe të zhvilluar.





# NDIQ UET, I GJEN TË GJITHA DEGËT!



Ceremonia e Diplomimit, korrik 2018



Pas dekadës së dytë duke filluar nga viti akademik 2018-2019, pas dy proceseve të para të licencimeve, UET rishtrukturoi gjerësisht ofertën e tij akademike dhe plotësoi gamën e programeve duke krijuar në projektin e tij strategjik 75 programe studimesh, të shtrira në 5 fakultete, të shoqëruara në 125 profile dhe të shtrira në një gamë prej 750 lëndësh. E gjithë kjo ofertë akademike e plotë, duke filluar nga Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, Fakulteti i Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës si dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, mbulon thuajse të gjitha fushat, duke krijuar mundësinë që çdo student të gjejë diplomën që dëshiron në UET.

# STAFI AKADEMIK

## 2

**Një institucion si Universiteti European i Tiranës lider në sektorin e edukimit në Shqipëri, mes shumë pikave të forta, pikën më të fortë ka stafin akademik.**

### PEDAGOGËT MË TË MIRË

Pedagogët e UET mund të quhen realisht më të mirët. Kjo sepse me botimet, CV -të, kontaktet dhe eksperiencën e tyre, sjellin në universitet një traditë më shumë se 40 vjeçare të edukimit të lartë në Shqipëri. Ata sjellin eksperiencën e botës akademike perëndimore, ku kanë përfunduar doktoraturën, kanë bërë post-doktoraturën, kanë dhënë mësim, apo kanë marrë pjesë në eksperiencë të ndryshme. Të studiosh me më të mirët, të mësosh nga më të mirët, është faktori bazë për të pasur studime cilësore.

### PARADOKSI I EDUKIMIT

Kohët janë aq dinamike sa po të krahasojmë një libër fantastiko-shkencor të viteve 60', në më pak se 50 vite të gjitha shpikjet e parashikuara në atë libër janë arritur dhe shumë më tepër. Atëherë, si mund ta zgjidhim një paradoks

të madh të edukimit: pedagogë apo mësime të përgatitur në të shkuarën duhet të përgatisin në të tashmen studentë për të ardhmen. Ka vetëm një mënyrë – të kesh stafin më të mirë, më të azhornuar, më të lidhur me botën e punës dhe të menaxhimit në mënyrë që të mund t'u transmetosh studentëve përvojën, eksperiencën, dinamizmin dhe sensin e metodës për të zgjidhur problemet e së ardhmes që do të jenë ndryshe nga ato të së sotmes.

### MËSIMDHËNIA INTERAKTIVE

Ndryshe nga tradita e deritanishme e shkollave lindore, që theksojnë riprodhimin e thatë të njohurive, në UET theksohen aftësitë analitike dhe mendimi kritik, si dhe nxitet krijimtaria dhe inteligjenca e studentëve. Gjatë mësimin përdoren teknikat dhe metodat më moderne të mësimeve, përdoret teknologjia e lartë gjatë leksioneve dhe elementet audio-vizuale. Studentët nxiten për të filtruar vetë informacionin e ofruar nga pedagogët në kurrikula të përbëra nga materiale të përzgjedhura, duke shmangur përdorimin e vetëm të një teksti mësimor.

### PEDAGOGË SENIOR

UET, që prej themelimit të tij ka patur prioritet shtimin e pedagogëve Senior me qëllim prurjen e eksperiencës së tyre akademike në auditor.

# 25+

### PROFESORË

Profesorët tanë nuk kanë vetëm rolin e mësimeve në auditor por ata japin një kontribut të shquar në kërkimin shkencor.

# 50+

### LEKTORË

Mësime dhe vlerësimi janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë roli kryesor i lektorëve në UET është mentorimi i vazhdueshëm ndaj studentit përgjatë gjithë studimeve të tij.

# 50+

### ASISTENTË

Ndërthurja e pedagogëve të rinj me ata më të vjetër bën që studentët në auditor të marrin pikëpamje të shumta rreth tematikave të ndryshme.

# 50+

Ceremonia e Diplomimit,  
korrik 2018







# ZGJIDH UET, UNIVERSITET PRESTIGJIOZI!



Studentë në Hall of Fame UET, mars 2018



Po bëhen gati 15 vite nga ideja e krijimit dhe themelimit zyrtar të UET dhe pas tij ka tashmë një histori. Mijëra dhe mijëra studentë që kanë kaluar në auditoret e UET, më shumë se 10,000 diploma, më shumë se 3 procese akreditimi nga të cilat 2 ndërkombëtare, praktika dhe procese akademike të konsoliduara. Kudo gjen një shenjë të UET! Diploma të të gjitha cikleve, shtresa të ndryshme shoqërore dhe një formë shumë e konsoliduar gati 15 vjeçare e traditës së re të universiteteve private në Shqipëri.

# KARRIERA / ALUMNI TREGU I PUNËS

# 3

**Universiteti European i Tiranës ka prioritet të tij nxjerrjen e studentëve të kualifikuar në tregun e punës, mbështetjen dhe ndjekjen e karrierës së tyre hap pas hapi.**

## ZYRA E KARRIERËS

Kryen një sërë funksionesh të lidhura ngushtësisht me ofrimin e mundësive që studentët, gjatë kohës së studimeve, të mund të ndërtojnë rrjetin e tyre të njohjes për t'u integruar lehtësisht në tregun e punës, por edhe ndjekjen e tyre pas studimeve.

## KUSH I PUNËSON TË DIPLOMUARIT E UET?

Studentët dhe të diplomuarit në UET janë ndër më të kërkuarit në tregun e punës. Një nga pikat tona të forta është mundësia e gjerë e praktikimit, e cila jep përparësi në tregun e punës. Kjo është një listë e shkurtër e atyre që u besojnë studentëve tanë: Kompani private / Administratë Publike / Media / Përfaqësi diplomatike / Institucione të pavarura.

## BORDET E TREGUT TË PUNËS

Një ide pionere e UET është funksionimi prej 10 vitesh i Bordeve të Tregut të Punës. Bordet janë të atashuara pranë çdo departamenti dhe përbëhen nga 7 anëtarë, të cilët janë ish-studentët tanë. Bordet e tregut të punës janë një pikë kontakti për punësimin, praktikat profesionale dhe internshipet.

## PANAIRI I PUNËS

UET organizon çdo vit Panairin e Punës. Në të marrin pjesë kompanitë më të mëdha në Shqipëri të cilat zhvillojnë intervista pune me studentët e UET. Rreth 25% e studentëve të UET janë punësuar në kompanitë pjesëmarrëse.

## UET ALUMNI

Në qendër të filozofisë së UET si institucion arsimor gjithçka sillet rreth studentit; dija dhe shërbimi. Në UET funksionon shkëlqyeshëm trekëndëshi administratë-staf akademik-student dhe për secilën nga këto pika janë

ngritur institucione dhe zyra përkatëse për mbështetje dhe bashkëpunim. "UET Alumni" është fytyra jonë në treg, historiku dhe e ardhmja e universitetit. Shoqata "UET ALUMNI" u krijua më 13 Maj të vitit 2010. Atë kohë ishin një grup i vogël të diplomuarish, tashmë janë mbi 11 000 të diplomuar në Bachelor dhe Master në UET. Të gjithë këta janë lobistët më të mëdhenj të universitetit, janë mbledhësit e fondeve, aplikuesit për projektet, ata që gjenerojnë ide për programe të reja, që krijojnë tregjet e punës për universitetin.



ADELA DANAJ

## PRESIDENTE E UET ALUMNI

Ndihem e privilegjuar të jem në krye të këtij misioni në institucionin që shënoi një kthesë të rëndësishme në jetën time. Universiteti European i Tiranës ka luajtur një rol thelbësor në rritjen time profesionale dhe njerëzore. Ka qenë pikërisht eksperiencia në UET e cila ushqeu dhe formësoi ambicijen time për t'u përfshirë më tej në fushën akademike. UET më ka dhënë shumë ndër vitet! Ndaj, sot dhe në vitet në vazhdim më përket mua të jap kontributin maksimal në këtë institucion.



IRA ELBASANI

## FITUESE E ÇMIMIT UET ALUMNI 10 / 2019

Fituese e Çmimit të Karrierës, themeluese e kompanisë "We Translate Albania". Ky ishte një vit jubile për rrjetin UET Alumni, ku Ira Elbasani, studente e brezit të parë në UET, u shpall fituese e Çmimit të Karrierës. Ira i përket atij brezit të parë, ku sloganin e UET ishte sfidues si për vetë universitetin, por edhe për studentët që studionin.



# BËHU PJESË E RRJETIT TË UET!



Prof. Dr. Ermira Qosja, Zv.Rektore për Zhvillimin Institucional dhe Studentët



Në UET ke mundësi të takosh, shoqërizohesh, bashkëpunosh në planin social apo atë profesional me mijëra dhe mijëra studentë nga shtresa të ndryshme shoqërore, me kontakte të huaja me qindra profesorë dhe në përgjithësi komuniteti i pedagogëve, kërkuesëve shkencorë dhe studentëve të UET është shumë i gjerë. Në shoqërinë e sotme të rrjeteve është shumë e rëndësishme që t'i përkasësh një komuniteti i cili është i shtrirë kudo, në të gjitha nivelet e sektorit publik dhe privat. Duke studiuar në UET ti ke mundësi të krijosh marrëdhënie profesionale jo vetëm me mijëra studentë dhe qindra pedagogë të UET, por edhe me shumë profesionistë të fushave të cilët janë pjesë e projekteve, forumeve dhe leksione të hapura. Në UET janë diplomuar mbi 10 mijë studentë dhe më shumë se 1,000 pedagogë shqiptarë e të huaj kanë qenë pjesë e UET në 13 vite.

# NDËRKOMBËTARIZIMI ERASMUS+

# 4

UET është një institucion i arsimit të lartë, i përkushtuar në ndërkombëtarizimin e programeve të studimit, proceseve akademike dhe zhvillimit të stafit dhe kërkimit përmes mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. UET synon të bëhet një qendër e rëndësishme kombëtare dhe rajonale sa i takon bashkëpunimit universitar, shkëmbimeve me karakter kërkimor shkencor dhe debatin e ideve që promovojnë vlerat akademike dhe ato të qytetarisë europiane. Ne synojmë ofrimin e diplomave të përbashkëta me universitetet prestigjioze Europiane, me të cilat kemi ndërtuar partneritet në kuadrin e programeve të përbashkëta të studimit. Nëpërmjet kësaj zyre UET ka arritur një bashkëpunim të frytshëm me universitete partnere prestigjioze si: Malardalen University, Suedi, Lappeenranta University of Technology në Finlandë, The Hague University of Applied Sciences në Hollandë,

Emden-Leer University dhe Hochschule Ludwigshafen në Gjermani; NOVA University of Lisbon në Portugali, Universiteti i Salzburgut në Austri; Universiteti i Bolonjës, Pavia dhe Genoas në Itali; Central European University, Hungari, Lille University, Francë etj. UET bashkëpunon me CEU në kuadër të GTFP-program për rritjen e mësimdhënies anglisht në UET. Gjithashtu, ofron diplomë të përbashkët Master në Shkenca Politike -PoSIG, me Universitetin e Salzburg në Austri. Në periudhën kohore 2015-2019, përmes projekteve Tempus Sigma Agile dhe Erasmus+ International Credit Mobility (ICM), kanë fituar të drejtën për të kryer periudha mësimore ose kërkimore në universitete europiane më shumë se 250 studentë të UET. Nga ana tjetër, UET është një institucion pritës për 26 studentë nga universitete partnere, të cilët kryejnë në UET një ose dy semestra studimi në gjuhën angleze.

#### STUDENTË TË HUAJ

nga universitete partnere kanë kryer më shumë se një semestër studimi në UET në gjuhën angleze

# 50+

#### UNIVERSITETE PARTNERE

ndërkombëtare me të cilët UET ka marrëveshje për projekte të përbashkëta, kërkime shkencore, shkëmbime stafi dhe studentësh

# 125+

#### STUDENTË TË UET

kanë kryer më shumë se një semestër studimi në universitetet më prestigjioze europiane

# 250+



Studentë në Panairin  
Ndërkombëtar të studimeve  
UET, prill 2018



# IV BËHU NDËRKOMBËTAR NË UET!



Ani Treska dhe Antonela Çekixhi- Studente në UET , fituese të bursës "Erasmus+" në Gjermani



Sot studimet janë globale. Të studiosh jashtë një cikël studimi, të studiosh një semestër apo të bësh një tjetër program studimesh, të jesh në kontakt me profesorë të huaj, praktika të huaja, të jesh në auditor me studentë ndërkombëtarë, në një botë gjithnjë e më globale është një avantazh i UET. Numri i shkëmbimeve ndërkombëtare të UET, numri i studentëve ALUMNI të UET që kanë ndjekur një cikël studimi jashtë, numri i studentëve Erasmus, e rendisin UET ndër universitetet me një përqindje më të lartë të ndërkombëtarizimit. Projekte, shkëmbime, Erasmus, profesorë ndërkombëtarë e bëjnë UET një pedanë për të hyrë më lehtë në një botë ndërkombëtare. Ish-studentë të UET studiojnë sot nga Harvardi në Oxford, nga London School of Economics në Sorbonne dhe punojnë nga Banka Botërore në OKB, nga FMN tek Banka Qëndrore Evropiane.

# APLIKIMET & PRANIMET TARIFAT E STUDIMIT

# 5

**Disa nga pyetjet më të shpeshta lidhur me fillimin e studimeve në UET**

## **CILAT JANË DOKUMENTET E KËRKUARA PËR PRANIM NË CIKLIN BACHELOR?**

• Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe certifikatës së notave të shkollës së mesme • Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës • Certifikatë familjare ose personale • Kopje e mandatit të pagesës së tarifës së shkollimit

## **CILAT JANË DOKUMENTET E KËRKUARA PËR PRANIM NË CIKLIN MASTER?**

Fotokopje e noterizuar e diplomës së ciklit të parë dhe e listës së notave • Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës • Certifikatë familjare ose personale • Fotokopje e noterizuar e diplomës dhe e certifikatës së notave të shkollës së mesme • Kopje e mandatit të pagesës së tarifës së shkollimit • Dëshmia e njohjes së një prej gjuhëve të huaja (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht)

## **CIKLET E STUDIMIT DHE KOHËZGATJA E TYRE**

- Programet profesionale – 2 vite akademike (120 kredite)
- Programet Bachelor – 3 vite akademike (180 kredite)
- Programet e integruara – 5 vite akademike (300 kredite)
- Master Profesional – 1 vit akademik (60 kredite)
- Master i Shkencave – 2 vite akademike (120 kredite)
- Programet e Doktoratës – 3 vite akademike

## **SI MUND TË TRANSFEROHEM NË UET?**

UET, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare vendase ose të huaja, publike ose jopublike. Transferimi i studimeve kryhet në bazë të rregullores së UET, përpara fillimit të vitit akademik, brenda afateve të përcaktuara nga Ministria. Procesi i vlerësimit të kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet në dy faza: shqyrtimi paraprak dhe shqyrtimi përfundimtar.

## **DOKUMENTACIONI I KËRKUAR PËR TRANSFERIMIN E STUDIMEVE:**

• Dokumentacioni i kërkuar për pranimin në ciklin përkatës të studimeve • Listën e notave të fituara në institucionin nga studenti transferohet • Fotokopje të programeve të lëndëve (syllabuseve) që studenti kërkon të ekuivalentojë në UET • Vërtetimin e çregjistrimit nga institucioni nga transferohet, ku paraqitet dhe numri i matrikullës së studentit

## **REDUKTIME MBI TARIFAT**

Edhe pse UET ofron bursa të shumta studimi, në UET tarifa e një programi studimi fillon nga 625 Euro. UET aplikon zbritje në varësi të notës mesatare të maturës dhe të pagesave të menjëhershme për të gjithë ciklin e studimit, gjithashtu ofron edhe mundësinë e pagesës me këste.

## **KONTAKTONI**

### ME ZYRËN E PRANIMEVE

nëpërmjet adresës së email-it: [info@uet.edu.al](mailto:info@uet.edu.al)  
ose në numrin e telefonit **+355 68 20 16 616**.

Jeni të mirëpritur të na vizitoni në UET!  
(Zyra e Pranimeve ndodhet në hollin e Godinës A).

Adela Danaj dhe Odeta Cacaj,  
gjatë këshillimit të karrierës  
UET, mars 2018





# V AKSES PËR TË GJITHË NË UET!



Studentë gjatë aplikimit në bankë të nivelit të dytë për financim të studime me interes 0



Një universitet i madh ka mundësi të ndërtojë një shkallë shumë të gjerë tarifash, reduktimesh, bursash apo mbështetjesh financiare me interes 0. Duke filluar nga 625 Euro, ju mund të gjeni vendin tuaj në UET sipas llojit të diplomave, nivelit të studimit, duke kërkuar reduktime, mbështetje financiare, bursa apo financim me bankat e nivelit të dytë me interes 0. Të gjitha këto elementë e bëjnë UET të jetë i aksesueshëm për të gjithë, duke e bërë atë një universitet njëkohësisht prestigjioz dhe dinjitoz por dhe të aksesueshëm nga cilado shtresë shoqërore. Praktikisht UET ka një skemë financiare për studimet e gjithkujt në UET duke e "flakur" me kohë perceptimin se universiteti privat është vetëm universiteti i të pasurve: duke filluar nga bursa "Pashko", bursa "Kadare", bursat e Ekselencës, Bursta e Talentit, reduktimet për mesatare të mirë, të qenit në rrjet ose komunitet me familjarët.



# PROGRAMET & PROFILET E STUDIMIT

## DP/DIPLOMA PROFESIONALE

Kontabilitet

Menaxhim

Turizëm

Dizajn i Aplikuar dhe Modë

Aplikime Informatike

## BA/BACHELOR

### FINANCË

Bankë

Kontabilitet

Sigurime

Menaxhim i Organizatave

Informatikë Ekonomike

### MENAXHIM BIZNESI

Menaxhim i Organizatave

Marketing

Turizëm

Kontabilitet

Informatikë Ekonomike

## JURIDIK I PËRGJITHSHËM

### MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Siguri

Studime Europiane

Administratë Publike

Partitë Politike

Marrëdhënie Publike

### SHKENCA POLITIKE

Administratë Publike

Partitë Politike

Sociologji Politike

Gazetari

Studime Europiane

### SOCIOLOGJI

Sociologji Politike

Antropologji Sociale

Administratë Publike

Marrëdhënie Publike

Gazetari

### TEKNOLOGJI INFORMACIONI

Informatikë Ekonomike

Hartim Softweresh

Inxhinieri Telekomunikacioni

Grafikë – Dizajn

Multimedia

### INXHINIERI INFORMATIKE

Inxhinieri Telekomunikacioni

Hartim Software-sh

Informatikë Ekonomike

Grafikë – Dizajn

Menaxhim i Organizatave

### INXHINIERI INDUSTRIALE

Inxhinieri Elektrike

Inxhinieri Mekanike

Inxhinieri Kimike

Teknologji Informacioni

Menaxhim i Organizatave

### INXHINIERI NDËRTIMI

### KOMUNIKIM

Marrëdhënie Publike

Gazetari

Grafikë – Dizajn

Multimedia

Marketing

### FILOZOFI

Filozofi Politike

Filozofi Gjuhe

Gazetari

Antropologji Sociale

Studime Europiane

### HISTORI

Trashëgimi Kulturore

Arkivistikë

Gazetari

Studime Europiane

Marrëdhënie Publike

### LETËRSI

Linguistikë

Antropologji Sociale

Trashëgimi Kulturore

Gazetari

Marrëdhënie Publike

### LINGUISTIKË

Gjuhë Angleze

Gjuhë Italiane

Gjuhë Spanjolle

Gjuhë Frënge

Gjuhë Gjermane

Gjuhë Kineze

Gjuhë Arabe

Gjuhë Turke

Gjuhë Greke

Gjuhë Ruse

### ARSIM PARASHKOLLOR

### PSIKOLOGJI

Shëndet Mendor

Psikologji Edukimi

Marrëdhënie Publike

Menaxhim i Organizatave

Marketing

### EDUKIM FIZIK DHE SPORTE

Atletikë

Gjymnastikë

Futboll

Lojëra me Dorë

Gazetari

### ARTE PAMORE

Grafikë – Dizajn

Multimedia

Pikturë

Regji

Trashëgimi Kulturore





# PROGRAMET & PROFLET E STUDIMIT

FAKULTETI  
I EKONOMISE  
BIZNESIT  
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI  
I SHKENCAVE JURIDIKE  
SHKENCAVE POLITIKE  
DHE MARRËDHËNIEVE  
NDËRKOMBËTARE

FAKULTETI  
I SHKENCAVE HUMANIE  
EDUKIMIT DHE  
ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI  
I INZHINIERISË  
INFORMATIKËS  
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI  
I SHKENCAVE  
MJEKESORE  
TEKNIKE

## ARTE SKENIKE

Regji  
Aktrim  
Balet  
Multimedia  
Marrëdhënie Publike

## ARTE MUZIKORE

Piano  
Violinë dhe Harqe  
Instrumente me Frymë  
Kitarë  
Kanto

## INFIERMIERI

## FIZIOTERAPI

## IMAZHERI

## PROGRAM I INTEGRUAR

### ARKITEKTURË

Arkitekturë Interieri  
Urbanistikë  
Restaurim Monumentesh  
Administrim Territori  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## MP/MASTER PROFESIONAL

### FINANCË

Banka dhe Tregje Financiare  
Kontabilitet & Raportim Financiar  
Auditim dhe Menaxhim Risku  
Administrim Publik  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

### AUDIT

Auditim dhe Menaxhim Risku  
Auditimi i Institucioneve Financiare  
Kontabilitet dhe Raportim Financiar

## Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

Administrim Publik

## MENAXHIM BIZNESI

Menaxhimi SME-ve  
Menaxhim i Burimeve Njerëzore  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh  
Administrim Publik  
Administrim Territori

## MARKETING

Turizëm  
Inovacion  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh  
TV Multimedia  
Marrëdhënie Publike Politike

## DREJTËSI

E Drejtë Administrative  
E Drejtë Europiane  
E Drejtë Ndërkombëtare

## STUDIME TË SIGURISË

Çështje të Sigurisë  
Studime Rajonale  
Gjeopolitikë  
Siguria e Sistemeve të Informacionit  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## KOMUNIKIM

Gazetari dhe Media të Reja  
Marrëdhënie Publike Politike  
Shkrim Krijues  
Menaxhim Marketingu  
TV Multimedia

## MËSUESI PËR ARSIMIN FILLOR

## PSIKOLOGJI E APLIKUAR

Psikologji Klinike  
Psikologji Shkollore  
Psikologji Këshillimi  
Psikologji Organizacionale  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## INFORMATIKË E APLIKUAR

Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh  
Menaxhim të Dhënash  
Siguria e Sistemeve të Informacionit  
TV- Multimedia  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## INFIERMIERI

Infermieri në Kujdesin Shëndetësor  
Parësor  
Infermieri Kirurgjikale  
Nutricion dhe Dietologji

## MSH/MASTER I SHKENCAVE

### FINANCË

Banka dhe Tregje Financiare  
Kontabilitet & Raportim Financiar  
Auditim dhe Menaxhim Risku  
Administrim Publik  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

### ADMINISTRIM BIZNESI

Menaxhim Marketingu  
Administrim Publik  
Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh  
Kontabilitet dhe Raportim Financiar  
Administrim Territori

### E DREJTË PRIVATE DHE BIZNESI

E drejtë Private  
E drejtë Biznesi

### E DREJTË PUBLIKE DHE NDËRKOMBËTARE

E drejtë Penale  
E drejtë Publike dhe Kushtetuese  
E drejtë Ndërkombëtare dhe Europiane

### SHKENCA POLITIKE

Strategji Politike  
Administrim Publik  
Gjeopolikë



# PROGRAMET & PROFILET E STUDIMIT

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

Marrëdhënie Publike Politike

## MASTER IN POLITICAL SCIENCE (POSIG)

## MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Çështje të Sigurisë

Studime Rajonale

Gjeopolitikë

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

Strategji Politike

## SHKENCA KOMUNIKIMI

Gazetari dhe Mediat e Reja

Marrëdhënie Publike Politike

Shkrim Krijues

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

Menaxhim Marketingu

## STUDIME RELIGJIOZE

Krahasimi i Religjioneve

Gazetari dhe Mediat e Reja

Studime Rajonale

Çështje të Sigurisë

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## GJUHËSI E APLIKUAR

Gjuhë Angleze

Gjuhë Italiane

Gjuhë Spanjolle

Gjuhë Frënge

Gjuhë Gjermane

Gjuhë Kineze

Gjuhë Arabe

Gjuhë Turke

Gjuhë Greke

Gjuhë Ruse

## PSIKOLOGJI

Psikologji Klinike

Psikologji Shkollore

Psikologji Këshillimi

Psikologji Organizacionale

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM

Gjuhët dhe Komunikimi

Shkencat e Natyrës

Matematikë

Shoqëria dhe Mjedi

Teknologjia dhe TIK

Edukim Fizik, Sporte dhe Shëndeti

Arte

## MËSUESI PËR EDUKIMIN FIZIK

Edukim Shëndetsor

Sporte Individuale

Dietologji dhe Nutricion

Rehabilitim Sportiv

Sporte Kolektive

## TEKNOLOGJI INFORMACIONI

Zhvillim Software-sh

IT e Biznesit

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

TV-Multimedia

Inovacion

## INXHINIERI NDËRTIMI

Infrastrukturë Transporti

Inxhinieri Strukturash

Urbanistikë

Administrim Territori

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## INXHINIERI INFORMATIKE

Inxhinieri Software-sh

Siguria e sistemeve të Informacionit

Menaxhim të Dhënash

Dizenjim dhe Zhvillim Aplikimesh

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## INXHINIERI INDUSTRIALE

Inxhinieri Energjitike

Inxhinieri Kimike

Inxhinieri Mekanike

Inxhinieri Transporti

Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh

## INFERMIERI

## FIZIOTERAPI

Teknika Rehabilitimi

Rehabilitim Sportiv

## IMAZHERI DHE RADIOTERAPI

## MA/MASTER I ARTEVE

### ARTE PAMORE

Skenografi

TV-Multimedia

Mjeshtri Pikturë

Dizajn-Modë

Histori dhe Kritikë Arti

### ARTE SKENIKE

Mjeshtri Regjie

Mjeshtri Aktrimi

Koreografi

TV dhe Produksion

Skenografi

### ARTE MUZIKORE

Mjeshtri Piano

Mjeshtri Instrumentash me Harqe

Mjeshtri Instrumentash me Frymë

Mjeshtri Kitarë

Kompozicion

## DR/DOKTORATË

Shkenca Ekonomike

Shkenca Juridike

Shkenca Sociale



## 1

## “EARLY BIRDS”

## PARAREGJISTRIMET E HERSHME



Presidenti UET, Prof. Xhepa, duke akorduar bursat e ekselencës për maturantët e Institucionit Arsivor Jopublik Elite. Vlorë



“EARLY BIRDS”, pararegjistrimet e hershme. UET ka një lidhje 12-mujore me studentët e tij, dhe e fillon këtë relacion me kandidatët për studentë, që janë maturantë apo që kanë përfunduar studimet e mesme ose një cikël studimesh universitare dhe dëshirojnë të vazhdojnë më tej, ose të plotësojnë; ri-orientojnë studimet e tyre. Gjatë gjithë vitit Zyra e Pranimeve dhe Këshillimit të Karrierës ndjek një proces të integruar të këshillimit të karrierës, duke i dhënë mundësi shumë kandidatëve për studentë të zënë një vend për vitin e ardhshëm akademik në Universitetin Europian të Tiranës. Përmes reduktimeve të tarifave, 30 - 40 për qind, apo bursave dhe gjysëm bursave, studentët sigurojnë paraprakisht të drejtën për të vazhduar studimet në degën që dëshirojnë, apo plotësojnë kriteret.

# PROGRAMI 500+ 500 / PARTNERËT E BIZNESIT

# 2



Dita e Biznesit në UET. UET Open Weeks 2019, Panairi i Punës



Programi 500+ në UET synon të thellojë dhe materializojë kooperimin me biznesin dhe tregun e punës duke ofruar për të gjitha këto kompani një gamë shërbimesh, procesesh që kanë të bëjnë me natyrën e institucionit, dhe qëllimet e këtyre bizneseve. Ky projekt përfshin 500 kompanitë më të mëdha në vend dhe është një projekt i gjerë bashkëpunimi 5 vjeçar që ka si qëllim, thellimin dhe materializimin e kooperimit me biznesin në vend. Gjithashtu ky kooperim synon vlerësimin e performancave të programeve të studimit në UET, si dhe të bashkëpunimit me këto kompani duke i pasur ato prioritare për të integruar studentët, në internshipe deri në punësimin e tyre.



3

BURSAT  
UET

10

BURSA PASHKO

25

BURSA TALENTI

250

BURSA EKSELENECE

500

BURSA KADARE

750

GJYSËM BURSA



Niko dhe Marko Zhezha, përfitues të bursës "Pashko"



Këtë vit Universiteti Europian i Tiranës do të ofrojë 500 bursa për maturantët duke marrë për bazë përkushtimin e tyre karshi studimit. Ju mund të aplikoni online në faqen zyrtare të UET: <http://uet.edu.al/apliko-per-burse/>. Universiteti Europian i Tiranës vendos çdo vit një numër të caktuar bursash në dispozicion për studentët. Aktualisht në UET mbi 750 studentë janë përfitues të bursave të plota ose të pjeshme./ Bursa ekselence, Bursa "Kadare" për Humanitetet dhe Bursat "Pashko" për liberalizmin. Po ashtu, UET, duke filluar nga ky vit akademik, në kuadër të shndërrimit në universitet polivalent, promovon programe, profile apo cikle studimi me anë të gjysëm bursave. Gjithashtu, të gjithë maturantët me mesatare 9 - 9.5 përfitojnë gjysëm bursë dhe mbi 9.5, bursë të plotë ekselence.

# ERASMUS+ 250 / SHKËMBIME STUDENTORE

# 4



Aida Breti, Koordinatorë e Zyrës Erasmus+ në Shqipëri. Aktiviteti në UET, 30 vite ERASMUS.



UET, në kuadrin e projekteve ndërkombëtare dhe të programit Erasmus+, ka akorduar rreth 900 mijë euro bursa për mobilitetin e stafit dhe të studentëve. Vetëm me anë të Programit Erasmus+ kanë shkuar mbi 250 studentë dhe kanë ardhur 32 studentë të huaj, të cilët kanë kryer të paktën një semestër në UET. Në vite, UET ka ndërtuar ura bashkëpunimi me shumë universitete perëndimore, si dhe është bërë pjesë me sukses e projekteve zhvilluese akademike e shkencore në kuadrin e projekteve ndërkombëtare të arsimit të lartë. UET i ka kushtuar vëmendje këtij procesi, me qëllim përmirësimin e programeve të studimit dhe procesit akademik konform standardeve perëndimore.



5

UET

## 15 KLUBET STUDENTORE



Sport Club UET 2019. Finalja e Kampionatit të Futbollit UET



Interesat përtej auditorit të studentëve në UET zhvillohen nëpërmjet 11 klubeve studentore me natyrë shkencore dhe 4 klubeve të tjera që lidhen me pasionet sportive artistike. Çdo klub ka 50 anëtarë me aplikim. UET Klubi **Le Corbusier** - Arkitekturë & Dizajn / Klubi **Adam Smith** - Ekonomiks & Financë / Klubi **Philip Kotler** - Menaxhim / Klubi **Russell** - Filozofi / Klubi **Freud** - Psikologji / Klubi **Steve Jobs** - Inovacion / Klubi **Kadare** - Letërsi / Klubi **John Locke** - Drejtësi / Klubi i **Hipokratit** - Mjekësi / Klubi **Mc.Luhan** - Komunikim / Klubi **Marx** - Sociologji / UET ka githashtu UET **Sport Club**, UET **Musical Band**, UET **Theater Colony**, UET **Art & Design Colony**



# 15 VITE UET

## 15 DOCTOR HONORIS CAUSA

### 14+1 Honoris Causa në 15 vite.

Në traditën e universiteteve më të njohura ndërkombëtare, UET akordon me një frekuencë 1-2 tituj Honoris Causa në vit. Duke shenjuar si një mirënjohje e institucionit për veprimtarinë e jetës apo akte me interes të posaçëm në lidhje me Shqipërinë, zhvillimin, shkencën, kulturën etj. UET përzgjedh personalitete shqiptare apo të huaja, figura politike, shkencëtarë, juristë, filozofë, shkrimtarë apo nobelistë dhe figura institucionale. Në vitin e 15 akademik 2020-2021 UET do të akordojë titullin e 15-të



**BEHGJET PACOLLI**  
Ish-President i Kosovës



**DITËRO AGOLLI**  
Shkrimtar i madh shqiptar



**MUHAMMAD YUNUS**  
Nobelist në Ekonomi



**FATOS NANO**  
Ish-Kryeministër i Shqipërisë



**ANTHONY GIDDENS**  
Lord, Sociolog anglez



**KARIM KHAN**  
Avokat, çështja çame /Strasburg



**GIANNI BUQUICCHIO**  
Kryetar i Komisionit të Venecias



**ROGER SCRUTON**  
Filozof i famshëm anglez



**GIANNI DE BIASI**  
Ish-trajneri i Kombëtares



**BERNARD KOUCHNER**  
Administratori i Parë, Kosovë



**CHRISTOPHER R. HILL**  
Diplomat amerikan



**HASHIM THAÇI**  
President i Kosovës



**KOEN LENAERTS**  
Kryetari i Gjykatës së BE-së



**LUC FERRY**  
Filozof i famshëm francez





# 20 SHTATOR 2006 **THEMELIMI I UET**



Nga e majta:  
Blendi Kajsiu  
Adri Nurellari  
Ermal Hasimja  
Henri Çili




www.uet.edu.al



Universiteti  
Europian i  
Tiranës

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



ZGJIDH UET! Blv. Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, Tiranë,  
Cel.: 068 20 16 616, info@uet.edu.al www.uet.edu.al



## DIPLOMË PROFESIONALE/BACHELOR/MASTER PROFESIONAL/MASTER SHKENCAVE/MASTER EKZEKUTIV/PROGRAME TË INTEGUARA/DOKTORATURË

kontabilitet menaxhim turizëm financë menaxhim biznesi drejtësi marrëdhënie ndërkombëtare shkencë politike sociologji dizajn i aplikuar dhe modë psikologji komunikim arte pamore filozofi histori letërsi linguistikë arte skenike arte muzikore arsim parashkollor edukim fizik dhe sporte aplikime informatike teknologji informacioni inxhinieri informatike inxhinieri industriale inxhinieri ndërtimi infermieri fizioterapi imazheri

FAKULTETI I  
EKONOMISË BIZNESIT  
DHE ZHVILLIMIT

FAKULTETI I SHKENCAVE JURIDIKE  
SHKENCAVE POLITIKE DHE  
MARRËDHËNIEVE NDRËKOMBËTARE

FAKULTETI I SHKENCAVE  
HUMANË EDUKIMIT  
DHE ARTEVE LIBERALE

FAKULTETI I INXHINIERISË  
INFORMATIKËS  
DHE ARKITEKTURËS

FAKULTETI  
I SHKENCAVE MJEKËSORE  
TEKNIKE